



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmljeno / Predato Received / Delivery	05.05.2021	viti god. year.	1
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIPBTK	2207/2021		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.210/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1767/19 të datës 30.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.267/2019 të datës 06.05.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga “Tepelena”, PN, Hajvali, Prishtinë, kundër Vendimit me Nr. 14-070/01-0062479/19 të datës 16.04.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.267/2019 e datës 06.05.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.14-070/01-0062479/19 i datës 16.04.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Prishtinës.

A r s y e t i m

Komuna e Prishtinës më datë 05.02.2019 ka rishpallur konkursin për pozitën “Menaxher i Burimeve Njerëzore”, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, duke marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit, por që në bazë të njoftimit të datës 28.02.2019 me numër 14-030/01-47664/19 të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës nuk është për zgjedhur si kandidat i suksesshëm. Ankuesi kundër këtij njoftimi më datë 18.03.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës më datë 16.04.2019 nxjerr Vendim me Nr.14-070/01-0062479/19, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me Nr. 14-070/01-0062479/19 të datës 16.04.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.05.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2159/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 17.05.2019 ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Komuna e Prishtinës për përgjigje në ankesë, mirëpo Komuna e Prishtinës nuk ka dorëzuar përgjigjen në ankesë lidhur me pretendimet e ankuesit përveç dosjes së dërguar me rastin e mbikëqyrjes së kësaj pozite nga ana e Këshillit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020, ka qenë jo funksional për shkak të mos emërimit të anëtarëve nga Kuvendi i Kosovës, me ç'arsye Këshilli me data 21.06.2021 ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës së tij me numër A.nr.267/2019 të datës 06.05.2019, duke udhëzuar të njëjtin për të drejtën e ndjekjes së procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Pas këtij njoftimi të Këshillit, ankuesi ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr.1767/19 të datës 30.03.2021 i pranuar në Këshill me datë 01.04.2021 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 18.03.2019 dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e ankuesit të datës 06.05.2019.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesa me numër protokollit 2159/2019 e datës 06.05.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e rishpallur të datës 05.02.2019 nga Komuna e Prishtinës për "Menaxher i Burimeve Njerëzore"; Njoftimin e datës 22.02.2019, 28.02.2019; E-mailin e datës 05.03.2019, 06.03.2019 nga ankuesi për E-mailin e datës 06.03.2019 nga ankuesin; E-mailin e datës 22.02.2019, 26.02.2019 nga Burimeve Njerëzore për ankuesin; Formularin për kërkesë apo ankese i datës 18.03.2019; Ankesën e datës 18.03.2019 e parashtruar nga ankuesi për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës; Vendimin me Nr. 14-070/01-0062479/19 të datës 16.04.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës; Njoftimin e datës 18.04.2019; Konkursin e shpallur të datës 20.03.2019 nga Komuna e Prishtinës për "Udhëheqës i Sektorit të Rendit Komunal"; Njoftimin për moszbatim të Aktvendimit Cp.nr.229/16 të ankuesit; Aktvendimin Cp.nr.229/16 të datës 07.02.2017 dhe 08.06.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Aktvendimin CA.nr.3777/2018 i datës 08.06.2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; E-mailin e datës 14.03.2017, 11.03.2017 nga E-mailin e datës 15.03.2017 nga ankuesin; E-mailin e datës 13.03.2017, 01.12.2017 nga Propozimin për Përmbarrim të 16.02.2016; Vendimin A 02/560/2015 i datës 29.12.2015 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 19.03.2015, 18.08.2015, 03.09.2015; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 17.05.2019 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për Udhëheqësin e Personelit të Komunës së Prishtinës; Fletë kthesë e datës 17.05.2019; Regjistrin e Aplikacioneve të pranuar; Deklaratën e datës 20.02.2019; Vendimin e datës

20.02.2019 për formimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Formularin Form.MAP-SHCK-10 për renditjen përfundimtare të kandidatëve i datës 28.02.2019; Formularin Form.MAP-SHCK-09 për mbledhjen e vlerësimeve individuale; Formularin Form.MAP-SHCK-11 për raportin final i rekomandimi nga komisioni rekrutues; Kërkesën për punësim të ankuesit, kandidatit

Përparim

dhe së bashku me dëshmitë e përgatitjes profesionale dhe të përvojë së punës; Formularin Form.MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë për kandidatët

E-mailin e datës 15.08.2019 për dhe Vendimin me Nr. 207/2018 dhe Nr. 208/2018 të datës 16.08.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.1767/19 të datës 15.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesën e datës 19.06.2019 të ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e lëndës një nga një dhe të gjitha bashkërisht, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Burimeve Njerëzore, ka pas shkelje esenciale të dispozitave ligjore, duke shtuar tutje se pranimi i Menaxherit të Burimeve Njerëzore është dashur që të bëhet përmes Procedurës së ngritjes në detyrë, kandidati i propozuar nuk ka plotësuar kushtet e konkursit, emërimi i Komisionit Përzgjedhës është bërë në mënyrë të kundërligjshëm sepse në Komision ka anëtarët me kualifikim bachelor dhe që janë ushtrues detyre, kandidati i emëruar vetë i ka përpiluar pyetjet e testit me shkrim, në testin me shkrim nuk ishte lënë hapësirë që të gjithë anëtarët e Komisionit të nënshkruhen në çdo fletë të testit, Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është i kundërligjshëm. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, të shfuqizoj Njoftimin me numër 14-030/01-47664/19 të datës 28.02.2019 për kandidatin e suksesshëm si dhe konkursin e rishpallur me datë 05.02.2019 dhe ta detyroj Kryetarin e Komunës së Prishtinës që të shpall Konkurs të Brendshëm për Avancim.

Kolegji lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar Aktvendimin Cp.nr.229/16 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilën është anuluar procedura e rekrutimit të rishpallur më datë 29.07.2015 për pozitën Udhëheqësi i Personelit në Komunën e Prishtinës, si dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë, e si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar së meqenëse procedura e rekrutimit për pozitën e kontestuar është anuluar dhe rikthyer në gjendje të mëparshme, Komuna e Prishtinës nuk ka qenë e detyruara që të shpall Konkurs të brendshëm për Avancim, në këtë rast Komuna e Prishtinës me rastin e rishpallje së konkursit për pozitën "Menaxher i Burimeve Njerëzore, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, kështu që pretendimi i ankuesit në këtë kuptim është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se kandidati i propozuar nuk ka plotësuar kushtet e konkursit, ka konstatuar që në konkursin e

shpallur të datës 05.02.2019 kritere bazë për këtë pozitë kanë qenë: *"Diplomë universitare Fakulteti Juridik ose Administratë Publike, minimum 5 vite përvojë pune"*, e si rrjedhojë Kolegji nga shqyrtimi i dokumentacionin të aplikimit ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur posedon Diplomë të lëshuar nga Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës me të cilën dëshmohet se më datës 10.09.2004 ka mbaruar studime themelore në Degën e Administratës Publike dhe me përvojë të punës prej muajit nëntor 2006 deri më datë 30.06.2013 në NDI në pozitën Zyrtar i Programit. Ndërsa ndërlidhur me këtë, pretendimi i ankuesit se kandidati i zgjedhur ka vetëm kualifikim beachelor, Kolegji e vlerëson si të pa bazuar, për arsye se përmes konkursit është kërkuar që kandidatët të kenë diplomë në fushën përkatëse dhe nuk ka përcaktuar beachelor apo master, Andaj, Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e përfshirjes së në listën e shkurtë ka vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve si në vijim: arsimimin dhe kualifikimin profesional dhe përvoja e punës"*, e mbi këtë konstatim rezulton se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Përkritazi me pretendimin ankimor se emërimi i Komisionit Përzgjedhës është bërë në mënyrë të kundërligjshëm, sepse në përbërje të këtij Komisioni ka anëtarë me kualifikim bachelor dhe që janë ushtrues detyre, Kolegji duke u bazuar në nenin 7 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, vlerëson se me këtë dispozitë ligjore nuk është paraparë që anëtarët e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil, të kenë diplomë të nivelit, bachelor, master apo doktoraturë, dhe së një Ushtrues Detyre bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, posedon të gjitha autorizimet dhe përgjegjësitë ligjore sikurse mbajtësi i rregullt i pozitës. Andaj, në kuptim të kësaj Kolegji konstaton se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka qenë i emëruar në pajtim me nenin 7 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, e mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se kandidati i emëruar Avni Zuka, vetë i ka përpiluar pyetjet e testit me shkrim, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës nuk ka mundur të provoj një pretendim të tillë, e në këtë kuptim pretendimi i ankuesit është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se në testin me shkrim nuk ishte lënë hapësirë për nënshkrim të çdo flete të tekstit nga anëtarët e Komisionit Përzgjedhës, Kolegji bazuar në nenin 36 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil vlerëson se më këtë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar një kërkesë e tillë, kështu që pretendimi i ankuesit është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është i kundërligjshëm, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 14-070/01-0062479/19 të datës 16.04.2018, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike të çështjes në procedurë të ankesës, e më këtë ka vepruar në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, e në këtë kuptim rrjedhë së pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Bazuar në Formularin e të Renditjes Përfundimtare të Kandidatëve, kandidati i përzgjedhur pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë është vlerësuar me gjithsej 89.5% pikë, ndërsa ankuesi është renditur i treti me gjithsej 54.9% pikë, e mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civilë ku është përcaktuar se: *në Shërbimin Civilë emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin me të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe gojë.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave duke u bazuar në rrethanat si me lartë konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën Menaxher i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paaanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"* dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.210/2021

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

